

Fjalim i deputetit Toni Gogu

03.07.2023

– Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë që na ndiqni,

Është e vërtetë që sot është një ditë e shënuar, jo e çuditshme. Është një ditë e shënuar, sepse kanë kaluar vetëm 7 vjet nga momenti që ne së bashku nisëm udhëtimin drejt një sistemi drejtësie të shumëpritur.

Ne jemi tërësisht të vetëdijshëm, të paktën kjo anë e sallës së parlamentit, kurse ju me sa duket jeni të vetyshtur, sepse nuk shpjegohen ndryshe të gjitha këto pikëpyetje që paskeni sot, pas 7 vjetësh, madje edhe nga kolegë të rinj, të cilët kanë qenë tërësisht pasionantë në reformimin e sistemit të drejtësisë.

Megjithatë, një gjë është shumë e vërtetë: shtigjet që ne kaluam për të ardhur në këtë pllajë ku jemi sot, për shkak se rruga deri në majë është e gjatë dhe e vështirë, kanë qenë shumë të ndryshme, për shkak se shumica socialiste në vitin 2016 vinte me një kryetar partie të burgosur për 4 vjet me radhë nga prokurorë të përdorur politikisht si ushtarë shahu; vinim tërësisht të vjedhur politikisht nga kolegjet e famshme zgjedhore, që i merrnin e i bënin kutitë e votimit më keq se te pazari i Peqinit dhe vinim të vrarë në mes të sheshit nga persona, të cilët ende nuk kanë dhënë llogari. Ndaj, ishim të qartë se gjithë atë vuajtje, gjithë atë persekutim që kjo forcë politike kishte hequr, ne nuk do ta kthenim në helm për kundërshtarin, por do ta kthenim në një forcë krijuese për të dizenuar atë sistem drejtësie, që sot përpara këtij organi, përfaqësues i sovranit, pra popullit, po jep llogari.

Edhe sot qasjen e kemi shumë të ndryshme, sepse ne dëgjuam gjatë gjithë kohës që institucionet raportuan, kurse ju bërtitët, ashtu siç bërtisni gjithmonë.

Për turpin do të flas në fund, sepse tani do të flas për qasjet, se ç'do të thotë të rrish dhe të dëgjosh institucionet e pavarura të drejtësisë, të flasësh kur të të vijë radha dhe të mos bërtasësh përmes pyetjeve sikur ti e ke të drejtën monopol.

Nga drejtuesi i SPAK-ut dëgjova se përmes hetimeve proaktive, që të gjithë juristët e kuptojnë, kryesisht të prokurorisë, pushtetarë apo njerëz shumë afër pushtetit po përballen me drejtësinë, sikur të mos kishin jo mik, por sikur të mos kishin njeri mbi dhë, sepse dëgjova këtu që u tha se është drejtësia e mikut. Ndërkohë, jo shumë larg, por vetëm para 7 vjetësh, pushtetarët nuk shkonin as si dëshmitarë në sallën e gjykatës dhe kam përshtypjen se ende vuajnë nga gjykatofobia, sepse, sa u përmend gjykatën, ikin me vrap.

Kështu që me shumë kënaqësi profesionale dëgjova Prokurorin e Përgjithshëm, i cili në raportimin e tij tha se standardi që përdorin prokurorët për masat e sigurisë është i ndryshëm. Pra, Prokurori i Përgjithshëm me anë të këtij raporti është duke na thënë se janë disa prokurorë, të cilët kanë marrë në dorë atë “kalendarin e lirisë” dhe bëjnë kujdestarin se kujt do t’i japin liri dhe sa liri do t’i japin, tërësisht kjo në mënyrë të zhdrejtë dhe joproporcionale. Këtë nuk e thonë politikanët, por e thotë Prokurori i Përgjithshëm dhe kjo gjë ka ndryshuar sot, nga çfarë ka qenë dje.

Tek të dyja organet qeverisëse të sistemit të drejtësisë konstatoj se progresi nuk është as automatik, as i pashmangshëm, progresi ka vetëm tri elemente: vuajtjen, dhembjen dhe flijimin. Ndaj, dëgjova me dhembje, si një ish-koleg i tyre, por me shumë kënaqësi, që sot ne kemi gjyqtarë dhe prokurorë që kanë një ngarkesë të madhe pune, gjë të cilën nuk e kanë kolegët e tyre në Bashkimin Europian. Po të shikojmë shifrat, gjyqtarët dhe prokurorët në Bashkimin Europian marrin më pak se gjysma e ngarkesës së punës që marrin kolegët e tyre në Shqipëri. Pra, çdo gjyqtar italian, çdo gjyqtar francez, çdo gjyqtar spanjoll, çdo gjyqtar portugez, çdo gjyqtar holandez apo danez, të cilët vijnë dhe na japin neve ekspertizë, dhe mirë bëjnë, sot marrin më pak se gjysmën e ngarkesës së punës që marrin gjyqtarët apo prokurorët shqiptarë, si shërbëtorë publikë të drejtësisë, dhe për këtë ne duhet t’u themi atyre - faleminderit. Sot ne duhet t’i përhëndesim ata për eficiencën e treguar, sepse me aq pak gjyqtarë dhe prokurorë sa kanë mbetur nga ai sistem i kalbur dhe i korruptuar, që e ndërtoat dhe e qëndisët ju me aq mund e djersë, kjo që po ndodh sot është një heroizëm që po bëhet nga këta njerëz, të cilët shkojnë në punë pa u ndier, japin dënime me burgime të përjetshme dhe kthehen në shtëpitë e tyre sikur nuk kanë bërë gjë.

Së fundi, ne sot, kolegë, konstatojmë edhe një gjë tjetër, të cilën e kemi konstatuar prej kohësh, por kemi qenë të distancuar, ku nga kjo foltore ne pamë shembullin më të mirë të përndjekjes. Ne pamë se si u përdoq Zëvendëskryetarja e parlamentit, pamë se si u përdoqën prokurorët e ulur atje, kur iu tha: “Sakën se ju...” Nga kjo foltore sot u dëgjuan të bërtitura, u shantazhuan dhe u përdoqën njerëzit e drejtësisë, kolegët e parlamentit, por edhe familjarët politikë. Ju e kuptoni shumë mirë kur përndiqeni dhe kur ju thuhet: “Kujdes me mua, kujdes me babanë e përndjekjes politike në Shqipëri!”

Unë uroj që profesionistët e drejtësisë ta kenë dëgjuar dhe ta kenë parë këtë vepër penale dhe, ashtu siç veprojnë ata në mënyrë proaktive, me mjete specifike, siç e thonë vetë, të marrin masat e duhura. Në fakt, ka edhe një element tjetër kjo vepër penale që, kur bëhet fjalë për anëtarët e familjes dhe ka lidhje shpirtërore, më duket se dënimin e merr dyfish.

Sot ne dëgjua Prokurorin e Përgjithshëm, i cili raportoi tamam si një nëpunës i denjë i Republikës së Shqipërisë...

Pra, ai raportoi si një nëpunës i denjë dhe tha gjithçka që ai mendonte, së bashku me drejtuesit e Prokurorisë së Posaçme, ndaj unë dua t’i pyes kolegët e mi: ku ishit ju, kur ish-Prokurores së Përgjithshme i thuheshin fjalë, që asnjëri nga ne nuk i përdor në oborrin e shtëpisë, se në tavolinën e bukës, jo e jo?! Ku ishit ju, kur kryetari të Gjykatës së Lartë i thuheshin ato fjalë, të cilat i thuheshin edhe sot e kësaj dite?! Pse nuk flisni këtu dhe të thoni se si një nga strukturat, që deri tani rezulton

të jetë më e denja për drejtësinë shqiptare, por më e rënda për ne, për shumicën socialiste, ju i keni vendosur një konotacion dhe e thërrisni ...

Ju e dini shumë mirë, sepse i keni vendosur një emër të padenjë, e quani “SKAP” dhe pastaj vini e flisni këtu për drejtësinë, bëni edhe 20 pyetje.

Kolegë, besoj se ka ardhur momenti që këto 5 institucione të bashkëveprojnë. Pra, Prokurori i Përgjithshëm, drejtuesi i SPAK-ut dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë u shprehën se janë të gatshëm të luftojnë korrupsionin edhe në radhët e tyre, po ashtu janë të gatshëm të ndjekin edhe disiplinimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve, në mënyrë që ne të bëhemi një vend i denjë ku të vazhdojmë, siç e thashë, rrugën drejt majës së drejtësisë, sepse është një rrugë e gjatë, e lodhshme, e mundimshme dhe me shumë sakrifica.

Faleminderit!.